



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:057971

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05604436

KPPP.nr.830/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Dogana e Kosovës, me seli në Lagjen Kalabri, rr. "Rexhep Krasniqi" Nr. 1, në Prishtinë, kundër debitorit T.M. B.I., me NUI: 811966350, me seli në fshatin Xërxë, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson A.G. nga Suhareka, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.26/23 të datës 16.03.2023, të Përmbartuesit Privat Zija Bala, me seli në Pejë, jashtë seancës me datë 22.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit T.M. B.I., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.26/23, i datës 16.03.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Zija Bala.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.26/23, i datës 16.03.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Zija Bala.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit përmbartues - Aktvendimit Nr. 03.1.1-2022-191 i datës 19.09.2022, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbartimit, ndaj debitorit T.M. B.I., me seli në Rahovec, të cilin e ka detyruar debitorin që t'ia paguaj në emër të borxhit shumë prej 129,221.74 €, me kamatë vjetore 7.80% prej datës 13.09.2022, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe shpenzimet tjera të krijuara në pajtim me UA-MD nr. 01/2022, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm, me bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorit, sekuestrimin,

vlerësimin me shënimin e përmbartimit në librat publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve deri në përmbushjen e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se dispozitivi i urdhrit është i paqartë dhe i pakuptueshëm dhe se përmbartuesi privat gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, me arsyetimin se urdhri është mbështetur vetëm në provat të cilat i ka prezantuar kreditori, ndërsa përmbartuesi nuk e ka vërtetuar fare se a është bërë i plotfuqishëm ose i ekzekutueshëm aktvendimi. Ka shtuar që vendimi i kreditorit nuk është i plotfuqishëm dhe as i ekzekutueshëm, meqenëse debitori përmes të autorizuarit të tij me datën 19.09.2022 është ankuar, ndërsa me datën 10.11.2022 ankesa është refuzuar, ndërsa i njëjti me datën 05.01.2023 brenda afatit prej 30 ditësh ka ushtruar konflikt administrativ pranë Gjykatës Komerciale.

I ka propozuar gjykatës që të pranohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, të prishet në tërësi urdhri për përmbartim, si dhe të detyrohet debitori që të paguaj shpenzimet e taksës gjyqësore për prapësim, si dhe për përpilimin e prapësimin në shumën prej 487.00 € sipas tarifës së OAK.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar prapësimin e debitorit duke deklaruar se urdhri bazohet në vendimin përmbartues të dhënë në procedurë administrative si dokument përmbartues, andaj meqenëse debitori nuk ka kryer pagesën e përcaktuar me aktvendimin nr.03.1.2-2022-191 të datës 19.09.2022 brenda afatit ligjor të përcaktuar, ky aktvendim ka plotësuar kriteret ligjore për të qenë i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm. Më tutje ka shtuar se propozimi për përmbartim i kreditori përmban të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç janë: kreditori dhe debitori i saktësuar, dokumenti ekzekutiv, aktvendimet e bashkëngjitura, si dhe është precizuar saktësisht shuma e kërkuar dhe janë caktuar edhe mënyra si dhe objekti i ekzekutimit. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*.

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Aktvendimin Nr. 03.1.1-2022-191 të datës 19.09.2022, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata gjeti se Aktvendimi Nr. 03.1.1-2022-191 i datës 19.09.2022, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi Nr. 03.1.1-2022-191 i datës 19.09.2022, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimi Nr. 03.1.1-2022-191 i datës 19.09.2022, i nxjerrë nga Dogana e Kosovës, është bërë i formës së prerë me datë 02.10.2022 dhe i ekzekutueshëm me datë 02.11.2022.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se lidhur me këtë çështje ka iniciuar konflikt administrativ, mirëpo gjeti se Aktvendimi Nr. 03.1.1-2022-191 i datës 19.09.2022 përbën dokument përmbarimor konform nenit 24 par.3 të LPP-së, me të cilën përcaktohet se *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.”*, dhe bazuar në dispozitën e nenit 22 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, me të cilën është përcaktuar se: *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”*, rezulton se paraqitja e padisë nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përmbarimore dhe si rrjedhojë nuk e ndalon përmbarimin.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.830/23, datë 22.04.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.